

A është Maqedonia e gatshme për të filluar negociatat me UE-në lidhur me Kapitullin 27?

- Përmbledhje -

Maqedonia si një shtet i Ballkanit perëndimor paraqet sfidë për Unionin Evropian (UE). Ky përshkrim i shkurtë i politikës për ambientin jetësor teston përpjekjet integrative të Maqedonisë në këtë fushë. Qëllimi ynë është të nxjerrim një perspektivë ndryshe mbi perceptimin publik të Kapitullit 27 si pjesë e procesit euro-integrues.

Në periudhë të recesionit global, politika për ambientin jetësor shpesh anashkalohet pasi që konsiderohet si ngarkesë e madhe për mjetet buxhetore. Mu për atë, ky tekst ka për qëllim që ambientin jetësor ta vendos në vend të parë dhe ta drejton vëmendjen e publikut të gjerë kah të arriturat e Maqedonisë në sektorin e ambientit jetësor, para së gjithash për shkak të ndryshimeve dhe progresit të shënuar në këtë fushë.

Me këtë, ne synojmë shikim më pozitiv mbi situatën në ambientin jetësor në Maqedoni dhe progresin e vendit në përafrimin me UE-në. Përmes analizës komparative, ky tekst sjell në pah sfidat dhe pengesat e procesit të reformave në raport me ruajtjen e ambientit jetësor gjatë procesit të kyçjes së Sllovakisë dhe Kroacisë.

Si anëtare e re e UE-së, Sllovakia është zgjedhur me qëllim që të identifikohen mirë mënyrat me të cilat Sllovakia është ballafaquar me pengesat në ambientin jetësor gjatë procesit të eurointegritimeve. Kroacia është kandidat aktual për antarësim dhe si e tillë ndan numër të madh të sfidave me të cilat Maqedonia ballafaqohet në pjesën e harmonizimit të ligjeve me *acquis-in*.

Për shkak të përparimit në rrugën drejt UE-së, Kroacia paraqet model të dobishëm për Maqedoninë. Nga informacionet e nxjerra lidhur me ambientin jetësor në periudhën e paraantarësimit, mund të shihet se në rrugën e reformave Maqedonia dhe Kroacia kanë ngjajshmëri në ato sfida me të cilat Sllovakia është ballafaquar para hyrjes ë UE.

Maqedonia po shënon përparime në reformat për mbrojtjen e ambientit jetësor njëjtë si Sllovakia dhe Kroacia para nisjes së bisedimeve për antarësim, gjë që paraqet sinjal të qartë se vendi është i gatshëm të fillojë negociatat për antarësim lidhur me Kapitullin 27. Në një të ardhme të afërt pritet që Maqedonia të shënojë rritje ekonomike dhe teknologjike. Duke marrë parasysh që kërcënimet ndaj ambientit jetësor rriten me rritjen ekonomike, është shumë e rëndësishme që Maqedonia t'i plotësojë rregullativat evropiane për mbrojtje të ambientit jetësor.